

HIDROZIM T

Aditiv për betonim në temperatura të ulëta

Në përputhje me: EN 934-2 T6

FUSHA E APLIKIMIT

Betonim në kushte të temperaturave të ulëta të ambientit (më të ulëta se +5°C). Duke aplikuar Hidrozim T si dhe rekomandimet për betonim dimëror, hedhja e betonit mund të bëhet edhe edhe në temperatura deri në -20°C.

CILËSITË

- Mundëson që procesi i hidratimit të çimentos në temperatura të ulëta të zhvillohet siç duhet;
- Mundëson në fazë të hershme karakteristika të fortësisë së betonit;
- Zvogëlon kohën e ngurtësimit të betonit;
- Zgjat sezonin e ndërtimit gjatë gjithë vitit.

KARAKTERISTIKAT TEKNIKE

CILËSITË	METODA	VLERA E DEKLARUAR
Pamja	Vizuele	Lëng ngjyrë kafe
Masa e volumenit (në 20°C)	ISO 758	(1.32±0.03) g/cm ³
pH-lera	ISO 4316	7.5±1
Përmbajtja e klorureve	EN 480-10	≤0,1%
Përmbajtja e alkaleve	EN 480-12	≤2,0%

DOZIMI DHE PERFORMANSAT:

Doza e rekomanduar e Hidrozim T-së varion nga 0,5 në 2,0% kundrejt masës së çimentos në përzierjen e betonit. Dozimi varet nga temperatura e ambientit gjatë betonimit, temperaturat e pritshme për një periudhë 24-orëshe pas betonimit, lloji i seksionit që do të betonohet dhe ekspozimi i tij ndaj ndikimeve atmosferike. Në temperaturat deri në -10°C rekomandohet një dozë e Hidrozim T-së prej 0.5 deri në 1.0%, ndërsa në temperatura më të ulëta se -10°C (deri në -20°C), rekomandohet një dozë 1.0-2.0%. në raport me masën e çimentos në përzierjen e betonit. Temperatura e përzierjes së betonit të freskët gjatë aplikimit duhet të jetë së paku +5°C (për seksione të holla +10°C). Në temperatura të ulëta, kjo mund të arrihet duke ngrohur disa ose të gjithë përbërësit e përzierjes së betonit (ujë, çimento, agregat). Pas futjes së Hidrozimës T, përzierja e betonit duhet të përziehet për të paktën 4-5 minuta dhe betoni i përgatitur në këtë mënyrë duhet të inkorporohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Sipërfaqja e betonit të hedhur duhet të mbrohet nga ngrirja e sipërfaqes. Koha për lirim e dërrasave të kallëpimit duhet të vonohet në varësi të temperaturës, domethënë në arrijen e fortësisë së dëshiruar të betonit. Në rast të betonimit me Hidrozim T në temperatura më të ulëta se -10°C, është e nevojshme të merren masa të veçanta për mbrojtjen dhe kujdesin e elementeve të betonit (ngrohje, përdorim të materialeve termoizoluese). Për të fituar beton të cilësisë së lartë në temperatura të ulëta, me arrijen e hershme të karakteristikave të larta të fortësisë lartë dhe lëshimin më të shpejtë të dërrasave të kallëpimit, rekomandohet përdorimi i Hidrozim T-së në kombinim me aditivë nga grupi i plastifikuesve dhe superplastifikuesve. Brenda diapazonit të dozave të rekomanduara (nga 0,5 në 2,0% në masë të çimentos), Hidrozim T nuk ka ndikim të rëndësishëm në vetitë e betonit në gjendje të freskët ose të ngurtësuar. Për këto arsye, kur përdoret Hidrozim T, nuk është e nevojshme të ndryshohet përbërja e betonit që përdoret në kushte normale të temperaturës dhe për të cilin cilësia e kërkuar është vërtetuar nga testet e mëparshme.

Efektet e mbidozimit: Në rast të mbidozimit të Hidrozim T-së, mund të ndodhë një humbje e papritur e punueshmërisë së betonit të freskët, si dhe një përshpejtim i procesit të ngjites së betonit.

Fq 1 nga 2

KOMPATIBILITETI

Hidrozim T është kompatibel me disa aditivë nga programi ADING. Hidrozim T është kompatibel me të gjitha llojet e çimentos Portland, duke përfshirë çimento rezistente ndaj sulfateve.

Rekomandohet që Hidrozim T të aplikohet në kombinim me një nga aditivët nga grupi i plastifikuesve ose superplastifikuesve. Aditivët e ndryshëm në beton dozohen veçmas, pra nuk përzihen me njëri-tjetrin përpara se të hidhen në përzierjen e betonit.

PAKETIMI

Shishe plastike: 1.3 kg
Kanta plastike: 7 dhe 28 kg
Fuçi: 280 kg
Kontejnerë 1300 kg

RUAJTJA NË DEPO

Në paketimin origjinal, në një temperaturë prej -18°C deri në 35°C dhe të mbrojtur nga ekspozimi direkt i rrezeve të diellit. Afati i përdorimit: 12 mua

SHENJA PËR CERTIFIKIMIN E PRODHIMIT

 2032	
ADING AD Shkup, rruga Novoselski (rruga 1409) nr.11 1060 Shkup, Maqedonia e Veriut 09 GADA001/6 EN 934-2:2009+A1:2012 HIDROZIM T Aditiv për beton, përshpejtues të lidhjes EN 934-2:T6	
Përmbajtja e joneve të klorit	≤ 0,1% sipas masës
Përmbajtja e alkaleve	≤ 2,0% sipas masës
Veprimi korroziv	I përmban këto komponente të EN 934-1:2008-shit, Aneksi A.2: Nitrate

Rreziku për shëndetin: Hidrozim T nuk përmban substanca toksike, por pavarësisht kësaj, duhet pasur kujdes që materiali të mos bjerë në kontakt me lëkurën, sytë ose të gëlltitet. Në rast kontakti me lëkurën ose sytë, është e nevojshme të shpëlahet menjëherë me ujë të pastër të rrjedhshëm. Nëse gëlltitet, kërkoni kujdes mjekësor. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së produktit.

Zjarri: Hidrozima T është një lëng jo i ndezshëm. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së produktit.

Pastrimi dhe deponimi: Mbetjet e palidhura të Hidrozim T-së pastrohen me ujë. Paketimi i vjetër i përdorur duhet të hidhet sipas rregulloreve lokale për atë lloj mbetjeje. Informacion shtesë jepet në Fletën e Sigurisë së produktit.

Fq. 2 nga 2

ADING

ADING AD, Shkup – Novoselski pat (rr. 1409) nr.11, 1060 Shkup, R. e Maqedonisë së Veriut;
Tel.: +389/02 2034 840; Fax: + 389/02 2034 850; e-mail: ading@ading.com.mk; www.ading.com.mk



www.ading.com.mk